



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, par.1, pika b të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par.1, pika b të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 22.11.2005 merr

V E N D I M
MBI CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS
SË MJEKËSISË FAMILJARE NË FSHATIN SHKABAJ

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit të Qendrës së mjekësisë familjare në fshatin Shkabaj.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr.44, të evidencuar në fletën poseduese nr.63, Zona kadastrale Shkabaj, në sipërfaqe prej 12.00 arë.

Neni 3

Ky Vendim paraqetë bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejeimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësia e tyre e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr. 353-578, më 22.11.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri